




FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



Rregullore për Agjentë/Kompanitë

e

kontraktuara për Sponsorizim

të

Federatës së Basketbollit të Kosovës

**Federata e Basketbollit
të Kosovës**

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVË GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Në bazë të Nenit 21 alineja e të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme "FBK"), Bordi i FBK-së në mbledhjen e mbajtur më 07 Qershor 2021 miraton këtë:

Rregullore për Agjentë/Kompanitë e kontraktuara për Sponsorizim

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

Me Rregulloren për Agjentë/Kompanitë e kontraktuara për Sponsorizim të Federatës së Basketbollit të Kosovës do të përcaktohen modalitetet me dhe për Agjentët/Kompanitë që do të kontraktohen nga FBK për arritjen e marrëveshjeve me sponsorë, të cilët do të sponsorizojnë FBK-në dhe aktivitetet e ndryshme të saj, varësisht për çka arrihet marrëveshje me sponsorët.

Neni 2 – Qëllimi

Pas harmonizimit të Ligjit për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me projektligjin për Tatimin në të ardhurat e Korporatave, institucionet sportive në veçanti pritjet të kenë benifitet e saj nga ky ligj dhe Federata e Basketbollit të Kosovës do të shfrytëzojë këtë rast për të kontraktuar agjentë apo kompani që do të ndihmojnë atë për të siguruar sponsorë, qofshin ata të ligave, projekteve të ndryshme, Përfaqësuesve të Kosovës, apo të ndonjë tjetër event/aktiviteti që organizohet nga FBK, apo në bashkëpunim me FBK-në.

Neni 3 – Arsyja

- 3.1. Bordi i FBK-së ka vendosur që të kontrakttojë agjentë ose kompani për sigurimin e sponsorëve në dobi të zhvillimit të basketbollit kosovar në përgjithësi dhe të imazhit sa më të mirë të Federatës së Basketbollit të Kosovës.
- 3.2. Bordi i FBK-së si organ që bënë punë vullnetare, duke parë rritjen e volumit të punëve dhe aktivitetëve të FBK-së, si dhe duke parë rritjen e shpenzimeve të FBK-së, e ka parë të arsyeshme përpilimin e kësaj Rregulloreje, për çka e ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm ta përgatitë një të tillë.

Neni 4 – Marrëveshja

- 4.1. Bordi i FBK-së ka vendosur që me agjentët/kompanitë që do të kontraktohen për të ndihmuar FBK-në në gjetjen e sponsorëve do të nënshkruajë kontratë me kohëzgjatje varësisht nga marrëveshja që do të arrihet ndërmjet tyre.
- 4.2. Negociatat me agjentët/kompanitë që do të kontraktohen do të udhëhiqen nga Kryetari i FBK-së, dhe Sekretari i Përgjithshëm.
- 4.3. Ndërprerja e marrëveshjes dhe të gjitha kushtet tjera do të përcaktohen në kontratë.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Neni 5 – Mënyra

Agjenti apo kompania e kontraktuar nga FBK do të gëzojë të drejtën e përfitimit të deri në 20% nga kontrata e nënshkruar me sponsorin/ët.

Dhe kjo shumë mund ti jepet agjentit/kompanisë së kontraktuar në dy mënyra si më poshtë:

- Nëse sponsori vendos që FBK-së t'ia transferoj të gjitha mjetet njëherazi, atëherë agjentit/kompanisë së kontraktuar nga FBK do ti transferohet njëherazi shuma në vlerë deri në 20% të kontratës së nënshkruar (varësisht nga shifra-përqindja e arritjes së marrëveshjes me agjentin/kompaninë).
- Nëse sponsori vendos që FBK-së t'i transferoj në baza mujore dhe me këste mjetet e premtuara në bazë të kontratës së nënshkruar, atëherë agjentit/kompanisë së kontraktuar nga FBK do ti transferohet deri në 20% (varësisht nga shifra-përqindja e arritjes së marrëveshjes me agjentin/kompaninë) e shumës së kështit të transferuar nga sponsori.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

Neni 6 – Përgjegjësia

Përgjegjës për ekzekutimin e kësaj Rregulloreje është Sekretari i Përgjithshëm, nën mbikëqyrje të Kryetarit të FBK-së.

Neni 7

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

7.1. Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës si organ përgjegjës për zhvillimin e basketbollit në vendin tonë ka të drejtë të ndryshojë vlerën e përqindjes, deri në 20%, në më shumë apo më pak, konform Statutit dhe Rregullores së Punës së Bordit të FBK-së, nëse e sheh të nevojshme një ndryshim të tillë.

7.2. Përmbajtja kryesore e kësaj Rregulloreje, duhet të përfshihet në Planin e Marketingut të FBK-së për vitin që po vjen.

7.3. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Miratuar në Prishtinë, më 07.06.2021

Arben FETAHU
Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës

